



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1950/11 Prot.

Tiranë, më 26.07.2025

VENDIM

Nr. 177, Datë 16.07.2025

**“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE
FIGURËS SË KANDIDATES PËR MAGJISTRAT PROKUROR, E CILA ËSHTË
DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK
2024 - 2025, ZNJ. ANKELA DAKE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen plenare të datës 16.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatës për
magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin
akademik 2024 - 2025, znj. Ankela Dake”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1950, datë 10.07.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, pasi dëgjoi relatorin Moisi Duda si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim, Këshilli)* garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve.
2. Nga Shkresa nr. 73 prot, datë. 14.01.2025, protokolluar me tonën nr.79, datë 14.01.2025 me objekt *"Lista e kandidatëve për magjistratë (profili prokuror), të cilët mund të diplomohen për vitin akademik 2024-2025"*, e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se në përfundim të programit të Formimit Fillestar në vitin akademik 2024-2025 është parashikuar të diplomohen 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë për magjistratë prokurorë, ku një nga kandidatet rezulton të jetë znj. Ankela Dake.
3. Me Vendimin Nr. 24, datë. 13.02.2025, *"Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025"*, Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë prokurorë të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin 2025.
4. Me Vendimin Nr. 25, datë. 13.02.2025, *"Për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin akademik 2025"*, zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorin për secilin kandidat.

Pas hedhjes së shortit rezultoi se Relator për kryerjen e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten Ankela Dake u zgjodh Anëtar i Këshillit dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, z. Moisi Duda.
5. Në zbatim të Pikës 1, të Seksionit A, të Kreut VI, të Rregullores, në rrugë elektronike *(me e-mail)* me datë 18.02.2025, Relatori ka njoftuar kandidaten për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
6. Me e-mailin e datës 19.02.2025, znj. Ankela Dake ka deklaruar nëpërmjet postës elektronike se është njohur me fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës në cilësinë e kandidates për magjistrat prokuror, e cila do të diplomohet nga shkolla e magjistraturës në vitin 2025, duke deklaruar se nuk ka ndonjë situatë konflikti interesi me relatorin që është caktuar përmes procedurës së shortit në Këshill.
7. Njëkohësisht me e-mailin e datës 21.02.2024, kandidates i janë dërguar formularët përkatës sipas kërkesave të ligjit duke i kërkuar plotësimin dhe dorëzimin e tyre së bashku me Autorizimet për verifikim pranë çdo personi fizik ose juridik, publik ose privat, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave personale që lidhen me verifikimin e figurës dhe pasurisë si dhe përpunimin e këtyre të dhënave kudo ku ato janë të regjistruara nga Këshilli.
8. Në datë 25.02.2025, protokolluar me nr. 365, kandidatja Znj. Ankela Dake ka depozituar pranë Këshillit, si më poshtë:

- 
- i. Autorizimi për Këshillit të Lartë të Prokurorisë me qëllim sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;
 - ii. Deklaratë me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;
 - iii. Deklaratë mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;
 - iv. Deklaratë Individuale që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;
 - v. Formular Vetëdeklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
9. Në mbështetje të nenit 35, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, germës "b", të Kreut II, dhe Seksionit B, të Kreut VI, të Rregullores, Relatori ka ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës Ankela Dake.

A. VERIFIKIMI I PASURISË SË KANDIDATIT

10. Me shkresën nr. Prot., 674 Prot, datë 10.03.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), për verifikimin e pasurisë për kandidaten për magjistrat znj. Ankela Dake, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025.
11. Nga ana e këtij institucioni, është kthyer përgjigja me Shkresën nr. 99/23 Prot, datë 26.06.2025. ILDKPKI ka paraqitur aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë, për kandidaten për magjistrat, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës, znj. Ankela Dake.
12. Në këtë akt përfundimtar për subjektin deklarues znj. Ankela Dake theksohet se, nga ILDKPKI, është dërguar pranë Këshillit, Akti i kontrollit të plotë për Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë/për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës me nr. Prot., 801/24 Prot., datë 11.10.2022, sipas të cilit:
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Ky Akt Kontrolli përfshin periudhën deri në datë 28.06.2022.

13. Në datë 10.03.2025, znj. Ankela Dake ka dorëzuar pranë ILDKPKI, Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në

institucionet e sistemit të drejtësisë që kandidon për t'u emëruar Magjistrate profili Prokuror.

14. Për kryerjen e kontrollit të plotë të kësaj deklarate, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo-bankar, të dorëzuar nga vetë kandidatja me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr.99 prot., datë 12.03.2025 pranë institucioneve si Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, institucioneve të tjera financiare, institucioneve shtetërore si, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD).
15. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është konstatuar se, për kandidaten znj. Ankela Dake,
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
16. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Agjencia e Inteligjencës Financiare në datë 28.03.2025, ka informuar se: ***"Pas kërkimeve në sistemin elektronik, për kandidaten znj. Ankela Dake nuk disponohen të dhëna për transaksione apo pasuri të dyshimta. Nuk rezultuan raportime."***
17. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. Prot., 4476/1 Prot, datë 25.03.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informohet se: ***"Shtetasja znj. Ankela Dake nuk figuron e regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti privat si person fizik ose juridik"***.
18. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. prot 5376/1 Prot, datë 21.03.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka informuar se, nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave "Asycuda Eorld" ka rezultuar që, shtetasja znj. Ankela Dake ***"nuk ka kryer ndonjë veprim doganor import-eksporti. Gjithashtu, nuk rezultojnë deklarime të bëra për para CASH, çek, apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor për periudhën Mars 2004 deri më 18 Mars 2025"***.

19. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 3241 prot, datë 25.03.2025 të ISSH, është dërguar informacion i cili disponon të dhëna për kontributet të cilat mbledhen dhe dërgohen nga drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Eëbservice sipas formularit standard përkatës (formulari përmban të dhëna për pagën dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shëndetësore e cila rezulton të jetë realizuar për periudhën **Qershor 2022 - Tetor 2022**).

20. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me Shkresën nr. Prot., 5113/1 prot, datë 13.03.2025 të QKB, është dërguar informacion se shtetasja Ankela Dake ***“Nuk figuron të jetë pajisur me NIPT, si person fizik pranë Regjistrat Tregtar si person fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrat tregtar.***

21. ***Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrijmë në përfundimin se, ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatit të kontrolluar, Aktit të përgatitur nga ILDKPKI-ja si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë, është konkluduar se, nuk ka nevojë të kryhet hetim më i thelluar se ai i kryer nga ILDKPKI-ja.***

B. VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATIT

22. Mbi bazën e Formularit të Vetëdeklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, kandidatja *znj. Ankela Dake* rezulton se:

- nuk ka qenë e dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- nuk ka qenë e ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- nuk është caktuar ndaj saj ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
- nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj saj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- nuk është marrë ndaj saj masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- nuk ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 (një) muaj

23. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, e shkresën nr. 420/3 Prot, datë 27.03.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon si më poshtë:

Nga verifikimet në sektorin e protokoll arkivit sekret rezultoi se, ***në emër të shtetases Ankela Dake “nuk disponohen të dhëna apo indicje që cenojnë figurën e kandidatës. Gjithashtu rezultoi se nuk ka çështje penale, kallëzim apo ankesa ndaj saj”.***

24. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me Shkresën nr. 10166 Prot. (DB), datë 25.03.2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar konfirmon, se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie ***“nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetases Ankela Dake, për periudhën 02.07.2022 deri aktualisht”.***
25. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me Shkresën nr. 439/1 Prot, datë 28.03.2025, Byroja Kombëtare e Hetimit bën me dije se nga verifikimet e kryera nuk disponon informacion dhe të dhëna mbi kandidaten për prokurore znj. Ankela Dake.
26. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Berat, Gjirokastrë, Dibrë, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, në përgjigje të shkresave të dërguara në KLP, informojnë se: ***“Për shtetasen Ankela Dake nuk disponojnë të dhëna, apo indicje të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm, apo materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim”.***
27. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën nr.6064/1, datë 19.03.2025 dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibrë, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, në përgjigjet e tyre në mënyrë të përmbledhur na informojnë se: ***“Për shtetasen Ankela Dake nuk rezultojnë çështje penale/civile, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm”.***
28. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 498/1, datë 18.03.2025 dhe Gjykatat e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 1120/1 Prot, datë 01.04.2025, informon se: ***“Për shtetasen Ankela Dake nuk rezulton që të ketë procese gjyqësore penale ose të jetë dhënë ndonjë vendim penal në ngarkim nga këto gjykata”.***

➤ **Raportimi nga organet e specializuara**

29. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidaten znj. Ankela Dake iu kërkuar informacion institucioneve të shërbimeve shtetërore informative si: Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.
30. Me shkresat e dërguara nga Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së

Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, informohet se, për kandidaten znj. Ankela Dake,

- *Nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme,*
- *Nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,*
- *Nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.*

31. Referuar Deklaratës së datë 25.02.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike, kandidatja znj. Ankela Dake ka deklaruar se, nuk është anëtar në ndonjë parti politike, pasi kjo përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e magjistratit. Kjo deklaratë është lëshuar me përgjegjësi ligjore sipas nenit 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
32. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me Shkresën nr. 425/1 Prot, datë 21.03.2025, Shkolla e Magjistraturës informon se ndaj kandidates për magjistrate Ankela Dake **”nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë proces disiplinor”**.
33. Relacioni me gjetjet paraprake është miratuar në Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe iu komunikua elektronikisht kandidates. Në e-mail-in e datës 09.09.2025, kandidatja Ankela Dake ka konfirmuar njohjen dhe nuk ka kundërshtuar përmbajtjen këtij relacioni.
34. Përsa më sipër, Këshilli vlerëson të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, znj. Ankela Dake.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 159 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 29.09.2019, “Për miratimin e “Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale sipas Relacionit nr. 1950, datë 10.07.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror, e cila është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, znj. Ankela Dake.
2. Lejimin e kandidates Ankela Dake, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokuror.

3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe znj. Ankela Dake.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 16.07.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Erind Merkuri

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla